



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/45 Nr. i faq/Br.str./vo.pg 78

Data/Datum/Date 29.04.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 253 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 57/2009"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, kërkesës me Nr. Prot. 1045 e datës 07.04.2025 të Jonuz Shehu përfaqësues i "Esra Palace" SH.P.K., Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2025 merr këtë:

V E N D I M

Për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor)

1. Me këtë vendim miratohet kërkesa me Nr. Prot. 1045 e datës 07.04.2025 të Jonuz Shehu përfaqësues i "Esra Palace" SH.P.K. për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në pjesën e parcelës publike kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-01355-4 në zonën kadastrale Rahovec në sipërfaqe prej 8m² (shtatë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6880m² (gjashtëmijë e tetëqind e tetëdhjetë metra katror), e evidentuar në posedim të Komuna e Rahovecit.
2. Krijimi i të drejtës së kalimit në pjesën e parcelës kadastrale të cekur në nenin 1 të këtij vendimi i dedikohet të lartpërmendurit në nenin 1 të këtij vendimi, i cili është posedues i pronës private me Nr. P-71510057-01355-9 në sipërfaqe të përgjithshme prej 481m² (katërqind e tetëdhjetë e një metra katror), i cili nuk ka qasje në rrugën publike "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec dhe si bartës i të drejtës së kalimit sipas këtij vendimi do të ketë mbrojtjen e të drejtës së autorizuar dhe në kohë të pacaktuar për shfrytëzimin e të drejtës së kalimit, e cila rrjedh nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese publike komunale.
3. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që sipas detyrës zyrtare të bëjë regjistrimin e të drejtës së kalimit në librat kadastral.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.45/25
Me datë:29.04.2025

Arbër Zenuni
Kryesues i Kuvendit